



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 16-12668/14
Kaçanik, 30.04.2014

Në bazë të nenit 17(f) dhe 25.2 e Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 4.1, 4.2 dhe 5.2 të Ligjit nr. 03/L-087 Për Ndërmarrje Publike, të nenit 6(f) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30.04.2014, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRU “Bifurkacioni” SH.A- Njësia në Kaçanik

I.

Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit për KRU” Bifurkacioni” SH. A, Njësia në Kaçanik, për menagjimin e ujësjetllësit në territorin e komunës së Kaçanikut.

II.

Në përputhje me ligjet në fuqi, Komisioni do të jetë në përbërëje prej tre anëtarëve, dhe atë : një anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës.

III

Anëtarët e emëruar nga Kuvendi i Komunës janë:

1. Sherife Troni, dhe
2. Selim Reka.

IV.

Komisioni Komunal i Aksionarëve për KRU” Bifurkacioni” SH. A- Njësia në Kaçanik, vepron në emër të Komunës së Kaçanikut dhe në përputhje me Ligjin për Shoqërinë Tregëtare. Për mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësisve të cilat i janë përcaktuar me ligj, Komisioni nga pika 3 e këtij Vendimi i përgjigjet Kuvendit të Komunës me Raport me shkrim.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

VI.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Anëtarët e Komisioni;
2. Kryetari i Komunës,
3. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë –dhe përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, dhe
4. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi